

Deri te:
Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të Shkencave Zbatuara,
Universiteti i Tetovës

R E F E R A T

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Univerzitetin e Tetovës në lëminë e Projektimit arkitektonik (2.01.02.01 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Në lidhje me konkursin për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, të datës 29.05.2025, të shpallur në gazetat përkatëse: "Koha", dhe "Слободен Печат" dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, "www.unite.edu.mk", për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Projektimit arkitektonik (2.01.02.01 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin Shkencave të Zbatuara të Universitetit të Tetovës, me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara Nr.17-249/3, të datës 11.06.2025, formohet Komisioni recensues në përbërje :

1. **Prof.Dr. Andrea MALIQARI, kryetar** – profesor ordinar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Republika e Shqipërisë.
2. **Prof.Dr. Vlora Navakazi, anëtare** – profesor inordinar në Fakultetin e Arkitekturës pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës.
3. **Prof.Dr. Enis Jakupi, anëtar** – profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara pranë Universitetit të Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 172 të Ligjit për Arsim të Lartë ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 82/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.178/2021 dhe 58/2024), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara dhe Senatit të Universitetit të Tetovës këtë:

R A P O R T

Në konkursin e datës 29.05.2025, të shpallur në gazetat përkatëse: “Koha“, “Слободен Печат“ dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës: “www.unite.edu.mk“, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëminë Projektim arkitektonik (2.01.02.01 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara në Universitetin e Tetovës, ka konkurruar një kandidat i vetëm, edhe atë: **Doc.dr. Nuran Saliu**.

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE PËR KANDIDATIN (ELABORIM) NURAN GAJJUR SALIU

Kandidati: Nuran Gajjur Saliu

(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

Institucioni: Fakulteti i Shkencave të Zbatuara, Universiteti i Tetovës

(Emri i fakultetit/institutit)

Lëmia shkencore: Projektim arkitektonik

(2.01.02.01 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

1.1 Arsimimi

Kandidati Dr. Nuran Saliu, aktualisht në titullin docent, ka lindur më 04.03.1980 në fshatin Debresh, komuna e Gostivarit, Republika e Maqedonisë së Veriut. Arsimin fillor e ka përfunduar në vendlindje, ndërsa arsimin e mesëm e ka ndjekur dhe përfunduar me sukses në Gjimnazin “Pançe Poposki” – drejtimi matematiko-natyror, në Gostivar. Studimet universitare i ka filluar në vitin 1998 dhe përfunduar me sukses në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit – drejtimi Arkitekturë, në kuadër të Universitetit Politeknik të Tiranës, ku është diplomuar në vitin 2003. Punimin e diplomës e ka përfunduar me notën maksimale 10 (dhjetë) dhe ka fituar titullin profesional Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës.

Studimet pasuniversitare i ka vazhduar në vitin 2008 në Universitetin “La Sapienza” në Romë, Republika e Italisë, pranë Fakultetit të Arkitekturës “Valle Giulia”, në drejtimin Projektim për Shëndetësi. Në vitin 2009, i ka përfunduar studimet pasuniversitare me lavdata (Cum Laude), duke mbrojtur tezën e magjistraturës me temë: “Projekt për Spitalin e Përgjithshëm “Boris Kançeski” në Gostivar”, dhe ka fituar titullin Magjistër i Shkencave Teknike në fushën e Projektimit për Shëndetësi.

Studimet e doktoraturës i ka përfunduar në Universitetin Politeknik të Tiranës, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, në departamentin Projektim. Disertacionin e doktoratës me titull: “Metoda automatike të projektimit, me aplikim në projektimin e spitaleve”, e ka mbrojtur me sukses të lartë më 23.12.2019, duke fituar titullin **Doktor i Shkencave Teknike**.

1.2 Punësimi dhe përvoja arsimore

Pas diplomimit në vitin 2003, kandidati është punësuar si arkitekt në studion arkitektonike “Atelier 4” në Tiranë – Republika e Shqipërisë. Gjatë periudhës nga viti 2003 deri në vitin 2007, kandidati ka projektuar disa ndërtesa në Tiranë, duke përfshirë tipe të ndryshme objektesh, nga ndërtesa individuale, kolektive dhe shumëfamiljare banimi, deri te objekte publike për arsim, objekte sportive dhe objekte për kulturë.

Që nga viti 2007, kandidati është i punësuar në Universitetin e Tetovës, pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, fillimisht si asistent i jashtëm (nga shtatori deri në dhjetor të vitit 2007), e më pas si asistent i ri nga data 26.12.2007 deri më 10.04.2013 (Vendimi nr. 04-2654/1, datë 26.12.2007). Në vitin 2013, është zgjedhur në titullin asistent për lëndët nga fusha e arkitekturës në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara pranë Universitetit të Tetovës (Vendimi nr. 04-2690/1, datë 10.05.2013).

Më 16.11.2020, kandidati është zgjedhur në titullin **docent** për lëndët Studio Arkitektonike III, Studio Arkitektonike IV dhe Studio Arkitektonike V në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara pranë Universitetit të Tetovës. Që nga ajo kohë, ka mbajtur ligjërata dhe ushtrime në programin studimor të arkitekturës në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Universitetin e Tetovës.

Gjatë kësaj periudhe, kandidati ka qenë shumë aktiv si në veprimtarinë shkencore-kërkimore, ashtu edhe në jetën e përditshme, duke marrë pjesë në projekte, komisione, konferenca dhe aktivitete të tjera, të organizuara nga institucione shtetërore, si edhe nga institucione të tjera dhe shoqëria civile. Këto angazhime do të theksohen më konkretisht në pjesët përkatëse të elaboratit që kanë të bëjnë me veprimtarinë arsimore-shkencore, kërkimore dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm (nën I, II, III dhe IV).

Dr. Nuran Saliu (docent), ka qenë anëtar i këshillit shkencor të Konferencës Ndërkombëtare të Shkencave të Aplikuara në vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025, anëtar i këshillit shkencor të revistës Journal of Applied Science – SUT, JAS-SUT, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara (Vol.6 Nr. 11–12 – 2020; Vol.7 Nr. 13–14 – 2021; Vol.8 Nr. 15–16 – 2022; Vol.8 Nr. 17–19 – 2023; Vol.9 Nr. 20–21 – 2024), anëtar i këshillit shkencor të Konferencës së Katërt Ndërkombëtare për Arkitekturë dhe Dizajn Urban (ICAUD) (2021) – Tiranë, anëtar i këshillit shkencor të Konferencës së Parë Shkencore Ndërkombëtare HURBE2021 – Sarajevë, anëtar i këshillit shkencor të Collana FAU – Forum for Architecture and Urbanism (2021) – Tiranë.

Që nga viti 2021, Doc. Dr. Nuran Saliu është gjithashtu anëtar i jurisë së INSPIRELI – konkursi më i madh ndërkombëtar për studentë në fushën e arkitekturës.

1.3 Dispensa të brendshme për ligjërata dhe ushtrime

- Saliu, Nuran (2020): Tipologjitë e hapësirave të punës – parametra dhe standarde. Dispense e brendshme për përdorim të brendshëm nga studentët. Tetovë.
- Saliu, Nuran (2021): Tipologjitë e hapësirave për edukim – parametra dhe standarde. Dispense e brendshme për përdorim të brendshëm nga studentët. Tetovë.
- Saliu, Nuran (2021): Tipologjitë e hapësirave për shërbime hotelierike – parametra dhe standarde. Dispense e brendshme për përdorim të brendshëm nga studentët. Tetovë.
- Saliu, Nuran (2021): Tipologjitë e hapësirave për shërbime hotelierike – parametra dhe standarde. Dispense e brendshme për përdorim të brendshëm nga studentët. Tetovë.
- Saliu, Nuran (2022): Kompozime arkitektonike – Sisteme dhe radhë në kompozim. Dispense e brendshme për përdorim të brendshëm nga studentët. Tetovë.
- Saliu, Nuran (2022): Metodat e projektimit – nga arti në shkencë. Dispense e brendshme për përdorim të brendshëm nga studentët. Tetovë.

2. TË DHËNAT PËR VEPRIMTARINË EDUKATIVE – MËSIMORE

Kandidati Dr. Nuran Saliu (docent), fillimisht ka nisur punë në Universitetin Shtetëror të Tetovës më 01.09.2007 deri më 26.12.2007 si asistent i jashtëm. Nga 26.12.2007 ka filluar të punojë si asistent i rregullt në Universitetin Shtetëror të Tetovës, duke marrë titullin asistent i ri.

Gjatë periudhave shtator 2009 deri korrik 2013 dhe shtator 2015 deri shkurt 2017, ka qenë shef i programit studimor të Arkitekturës.

Në vitin 2013, është zgjedhur në titullin asistent për lëndët nga fusha e arkitekturës në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara pranë Universitetit të Tetovës (Vendimi nr. 04-2690/1, datë 10.05.2013). Pas përfundimit të studimeve të doktoraturës, më 16.11.2020, është zgjedhur në titullin **docent**, që është titulli i tij i fundit akademik deri më tani.

2.1 Mbajtja e mësimit (ligjërata dhe ushtrime)

a.) Lëndët e mbajtura në Cikël të parë	Vitet Akademike
Studio Arkitektonike III	2020/2021, 2021/2022, 2022/2023, 2023/2024, 2024/2025
Studio Arkitektonike IV	2020/2021, 2021/2022, 2022/2023, 2023/2024, 2024/2025
Studio Arkitektonike V	2020/2021, 2021/2022, 2022/2023, 2023/2024, 2024/2025
Kompozim Arkitektonike	2022/2023, 2023/2024, 2024/2025
Metodat e projektimit	2022/2023, 2023/2024, 2024/2025

Projektimi parametrik	2020/2021, 2021/2022, 2024/2025
Praktikë profesionale	2020/2021, 2021/2022, 2022/2023, 2023/2024, 2024/2025

6.) Lëndët e mbajtura në Ciklin e dytë Vitet Akademik

Studio Arkitektonike M1	2022/2023, 2023/2024, 2024/2025
Studio Arkitektonike M2	2023/2024, 2024/2025
Studio e Integruar	2023/2024, 2024/2025
Projektim Parametrik	2024/2025
Praktikë profesionale	2022/2023, 2023/2024, 2024/2025

Gjatë periudhës nga 26.11.2020 deri në shtator 2024, ka ushtruar funksionin e Koordinatorit të Ciklit të Dytë të Studimeve, ndërsa nga 20.05.2024 është në funksion si Koordinator i ECTS në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.

Kandidati Doc. Dr. Nuran Saliu ka qenë mentor i temave të diplomës për 19 studentë në ciklin e parë të studimeve, si dhe mentor i 2 studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Gjithashtu, ka qenë kryetar ose anëtar i komisioneve për 36 tema diplome në ciklin e parë dhe 12 tema diplome në ciklin e dytë të studimeve. E gjithë kjo dëshmon për një angazhim të gjerë dhe përvojë të akumuluar në fusha të ndryshme shkencore dhe profesionale.

3. TË DHËNAT PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE

Kandidati, Dr. Nuran Saliu (docent), edhe gjatë periudhës në shqyrtim, që nga marrja e titullit të fundit, ka qenë shumë aktiv në veprimtarinë e tij shkencore-kërkimore, si autor apo bashkëautor, gjë që pasqyrohet në punimet shkencore të publikuara në revista kombëtare dhe ndërkombëtare më të rëndësishme, si dhe në pjesëmarrjet në konferenca dhe simpoziume shkencore, ku trajtohen tema të rëndësishme dhe aktuale, si në nivel shkencor ashtu edhe në nivel shoqëror. Kjo veprimtari e kandidatit paraqitet më poshtë:

A. Publikime shkencore

Që nga zgjedhja e tij e fundit në vitin 2020, kandidati ka publikuar këto punime:

VITI 2025

1. **Nuran Saliu**, Kujtim Elezi. (2025). The transformative integration of artificial intelligence in architectural practice: from generative design to sustainable building performance. European Chronicle, 10(1), 66–73. <https://doi.org/10.59214/euch/1.2025.66>

2. **Nuran Saliu**, Kujtim Elezi. (2025). Integration of artificial intelligence in floorplan layout planning: a systematic review of models, methods, and applications. *European Chronicle*, 10(1), 57–65. <https://doi.org/10.59214/euch/1.2025.57>

VITI 2024

3. Fjolla Ibraimi, **Nuran Saliu**, (2024). An Inclusive Response to COVID-19: Transforming Learning Environments. In: Manahasa, E., Naselli, F., Yunitsyna, A. (eds) *COVID-19 (Forced) Innovations. The Urban Book Series*. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-031-56607-3_9

VITI 2023

4. **Nuran Saliu**, Egzona Zendeli Vejseli, Kujtim Elezi, Andrea Maliqari. (2023). The interaction of simple states in complex architectural rectangular shapes. *Journal of Applied Sciences-SUT*. Vol 9. No.17-18. 159-170. UDC: 721.021.2:004.925
5. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu** (2023). Housing quality in the city of berati: an analytical approach of typology and construction. *Journal of Applied Sciences-SUT*. Vol 9. No.17-18. 126-135. UDC: 711.4:728.1:94(496.5-51:560)

VITI 2021

6. Kujtim Elezi., **Nuran Saliu**. (2021). The Rise of Modernism in Tetova. In: Yunitsyna, A., Hysa, A., Manahasa, E., Naselli, F., Manahasa, O.D., Dervishi, S. (eds) *Current Challenges in Architecture and Urbanism in Albania. The Urban Book Series*. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-81919-4_13
7. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu** (2021). Brutalism: the new face of a city. In: Nepravishta, F., Maliqari, A. (eds) *Modernisation and Globalisation: New Paradigms In Architecture, City, Territory. Collana FAU - Forum for Architecture and Urbanism (FAU)*. La scuola di Pitagora editrice. Printing House FLESH, Tiranë 2021.
8. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu** (2021). Pristina and the Yale syndrome in architecture. *Journal of Applied Sciences-SUT*. Vol 7. No.13-14. 93-101. UDC: 72.036(497.115)
9. Fjolla Ibraimi, **Nuran Saliu** (2021). Understanding inclusive education and its impact on architecture. *Journal of Applied Sciences-SUT*. Vol 7. No.13-14. 34-45. UDC: 34.043.2:376-056.26/.36]:725.05(497.7)

VITI 2020

10. **Nuran Saliu**, Kujtim Elezi, Andrea Maliqari, Egzona Zendeli-Vejseli (2020). From Dimensional To Non-Dimensional Simple States: A Computational Design Method for Early Stages of Design. *Journal of Applied Sciences-SUT*. Vol 6. No.11-12. 71-84. UDC: 72.012:004.92-023

11. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**, Enis Jakupi. (2020). Bonta's interpretation of an architectural myth. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 6. No.11-12. 60-70. UDC: 2-264:72(497.7)

B. Tubime shkencore / Konferenca, Simpoziume

Viti 2025

1. **Nuran Saliu**, Kujtim Elezi, Fjolla Ibraimi. "Architectural Paradoxes Beyond Ai: The Unquantifiable Qualities Of Architecture". (2025) International Congress on Natural, Health Sciences and Technology | 7-8 May, 2025. 9th International Scientific Conference on Applied Sciences. 7-8 May, 2025

Viti 2024

2. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**, "Vernacular Architecture and National Identity: Bosnia and Macedonia Revisited". (2024). International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 8th International Scientific Conference on Applied Sciences. ISBN: 978-608-217-128-9
3. **Nuran Saliu**, Kujtim Elezi, Egzona Zendeli Vejseli. "A Comprehensive Exploration of The Nexus of Artificial Intelligence and Architecture". (2024). International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 8th International Scientific Conference on Applied Sciences. ISBN: 978-608-217-128-9
4. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**, "Vernacular Architecture and National Identity: Bosnia and Macedonia Revisited" (2024). UBT International Conference. 21. <https://Knowledgecenter.Ubt-Uni.Net/Conference/2024ubtic/Asp/21>

Viti 2023

5. **Nuran Saliu**, Egzona Zendeli Vejseli, Kujtim Elezi, Andrea Maliqari. The interaction of simple states in complex architectural rectangular shapes. (2023). Book of abstracts of International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 7th International Scientific Conference on Applied Sciences. ISBN: 978-608-217-117-3
6. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**. "Housing quality in the city of Berati: an analytical approach of typology and construction". (2023). Book of abstracts of International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 7th International Scientific Conference on Applied Sciences. ISBN: 978-608-217-117-3
7. Egzona Zendeli Vejseli, Minas Bakalcev, **Nuran Saliu**. "Hew types of housing between city and village, case study - Gajre village, Tetovo"(2023). Book of abstracts of International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 7th International Scientific Conference on Applied Sciences. ISBN: 978-608-217-117-3

8. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**, "Housing quality, an analytical approach of Typology and construction between the city of Ohri and Berat" (2023). UBT International Conference. 20. <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/IC/arch/20>

Viti 2021

9. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**, "Housing quality in the city of Berati: an analytical approach of Typology and construction" (2021). UBT International Conference. 220. <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2021UBTIC/all-events/220>
10. Fjolla Ibraimi, **Nuran Saliu**. "Understanding inclusive education and its impact on architecture". (2021). Book of abstracts of International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 5th International Scientific Conference on Applied Sciences.
11. Fjolla Ibraimi, **Nuran Saliu**, "An Inclusive Response to Covid-19: Transforming Learning Environments" (2021). Abstract Book of The Fourth International Conference on Architecture and Urban Design New & Old Normality Post 2020. 4-ICAUD November 24-26 2021. ISBN: 978-9928-135-38-4.

Viti 2020

12. **Nuran Saliu**, Kujtim Elezi, Andrea Maliqari, Egzona Zendeli Vejseli. "From Dimensional to Non-Dimensional Simple States: A Computational Design Method for Early Stages of Design". (2020). Book of abstracts of International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 4th International Scientific Conference on Applied Sciences.
13. Kujtim Elezi, **Nuran Saliu**, Enis Jakupi. Bonta's interpretation of an architectural myth. (2020). Book of abstracts of International Congress on Natural, Health Sciences and Technology. 4th International Scientific Conference on Applied Sciences.
14. **Nuran Saliu**, Andrea Maliqari, Kujtim Elezi " An algorithm for identifying simple states in complex rectangular shapes" (2020). UBT International Conference. 358. https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2020/all_events/358
15. Kujtim Elezi and **Nuran Saliu**, "From light to heavy, the spread of Modernism in Tetova" (2020). UBT International Conference. 357. https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2020/all_events/357

4. TË DHËNAT PËR VEPRIMTARINË PROFESIONALE-ARTISTIKE DHE ZBATUESE

Dr. Nuran Saliu (docent), gjatë gjithë kësaj periudhe që nga marrja e titullit të fundit, ka qenë shumë aktiv, duke marrë pjesë në komisione profesionale, debate dhe duke kontribuar në organizata profesionale të ndryshme të organizuara nga shoqata dhe forume të ndryshme. Veprimtaria profesionale dhe aplikative e kandidatit përfshin:

- Projektues i projekteve ideore arkitektonike
- Projektues i disa projekteve bazë
- Mbikëqyrës i disa objekteve të ndërtuara
- Dizajner i më shumë se 30 interierëve
- Koordinator i ekspozitave për lëndët Studio Arkitektonike 3, 4 dhe 5
- Anëtar i jurisë në INSPIRELI – konkursi më i madh ndërkombëtar për studentë të arkitekturës
- Anëtar i komisionit në konkursin mbarëshqiptar për studentë, për zgjidhje ideore mbi riciklimin
- Pjesëmarrës në konkursin ndërkombëtar për zgjidhje ideore për çerdhe në Prishtinë
- Pjesëmarrës në aktivitetin “Ditët e hapura” të organizuar nga Universiteti – Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

5. TË DHËNAT PËR VEPRIMTARINË ME INTERES MË TË GJERË

Dr. Nuran Saliu (docent), aktualisht është koordinator për kreditë ECTS në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara. Është aktiv në jetën shoqërore si profesor dhe ekspert profesional në fushën e arkitekturës, në organizata shkencore, debate dhe tribuna profesionale e shkencore, konferenca, si dhe në media të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij si në shoqëri, ashtu edhe në profesion.

Doc. Dr. Nuran Saliu është anëtar i Shoqatës së Arkitektëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe anëtar i Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dr. Nuran Saliu është i pajisur me autorizimin A për ekzekutim, si dhe me autorizime të tipit B për projektim, revizion dhe mbikëqyrje.

Dr. Nuran Saliu është anëtar aktiv i Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe ka qenë anëtar i disa komisioneve të cilat janë të elaboruara në shtojcën e këtij raporti.

Doc. Dr. Nuran Saliu është gjithashtu anëtar i jurisë në INSPIRELI – konkursi më i madh ndërkombëtar për studentë në fushën e arkitekturës.

6. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcë, bashkangjesim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr.Nuran Saliu (Docent), ka gjithsejt 309,13 pikë, edhe atë:

- | | |
|---|-------------|
| - Veprimtaria mësimore-arsimore | 114.13 pikë |
| - Veprimtaria shkencore-hulumtuese | 64.50 pikë |
| - Veprimtaria profesionale – artistike dhe zbatuese | 99.00 pikë |
| - Veprimtaria me interes të gjerë | 31.50 pikë |

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	114.13
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	64.50
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ARTISTIKE DHE ZBATUESE	99.00
VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	31.50
Gjithsejt	309.13

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Bazuar në vlerësimin e dokumentacionit, komisioni vlerëson se kandidati **Dr. Nuran Saliu** (docent), edhe pas zgjedhjes në titullin docent, ka treguar një veprimtari të suksesshme dhe të denjë në fushën mësimore-shkencore, kërkimore-shkencore, si dhe në veprimtarinë me interes të gjerë në Universitetin e Tetovës, dhe me këtë i plotëson tërësisht kushtet e përcaktuara në konkurs, si dhe dispozitat e parashikuara me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Punimet e tij shkencore, të botuara si referenca të veçanta në revista shkencore, dëshmojnë për profilin e tij dhe përgatitjen për të ndjekur gjithmonë temat aktuale nga fusha e arkitekturës.

Komisioni i recenzues konstaton se kandidati **Dr. Nuran Saliu** (docent), i përmbush kriteret e përcaktuara për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor Profesor i Asociuar, në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen e titujve mësimor-shkencorë, shkencorë, mësimor-profesionalë dhe bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, përkatësisht Ligjin për Arsimin e Lartë të RMV-së, me një total prej **114.13 pikëve** nga veprimtaria mësimore-edukative, **64.50 pikë** nga veprimtaria kërkimore-shkencore, **99.00 pikë** nga

veprimtaria profesionale-artistike dhe aplikative dhe **31.50 pikë** nga veprimtaria me interes më të gjerë, me një total prej **309.13 pikësh**.

Për këtë arsye, kemi nderin dhe kënaqësinë t'i propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, që kandidati **Dr. Nuran Saliu** (docent) të zgjidhet në titullin mësimor-shkencor **Profesor Inordinar** (Asociuar) në fushën e **Projektimit arkitektonik**, në Programin Studimor Arkitekturë, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara - Universiteti i Tetovës.

Shpresojmë se zgjedhja e tij në këtë titull do të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë mësimore-shkencore, kërkimore-shkencore dhe veprimtarive me interes të gjerë në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara pranë Universitetit të Tetovës.

Tetovë, 2025

Me respekt,

KOMISIONI RECENZUES

Prof.Dr. Andrea MALIQARI, kryetar

Profesor ordinar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës
pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Republika e Shqipërisë

Prof.Dr. Vlora Navakazi, anëtare

Profesor inordinar në Fakultetin e Arkitekturës pranë Universitetit
të Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës..

Prof.Dr. Enis Jakupi, anëtar

Profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara pranë
Universitetit të Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË THIRJE PROFESOR INORDINAR

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Suksesi mesatar në ciklin e parë: Suksesi mesatar në ciklin e dytë: <u>10.0</u> (Cum Lauda) Suksesi mesatar <u>8.45</u> për studimet e integruara. Kushtet e përgjithshme në titujt mësimorë-shkencorë Neni 166 (5) Për personat që kanë themeluar marrëdhënie pune si docent, profesor inordinar, asistent, asistent doktorant, ose asistent i ri në një nga universitetet në Republikën e Maqedonisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen dispozitat e paragrafit (2) alinesë 1 dhe paragrafit (3) alinesë 1, gjatë zgjedhjes së tyre në titullin e njëjtë ose më të lartë mësimor-shkencor, pavarësisht nga cili institucion i arsimit të lartë kryen zgjedhjet e reja.	PO
2	Titulli shkencor – doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës: Inxhinieria dhe teknologjia (2), fusha shkencore <i>Ndërtimtaria (2.01)</i>, nënsfera shkencore <i>Arkitekturë (2.01.02)</i>, lëmia shkencore <i>Projektim Arkitektonik (2.01.02.01)</i>.	PO
3	Të publikuara së paku pesë punime shkencore të recensuara në publikime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	PO
3.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar për arsimin e lartë 1. Emri i revistës shkencore: - <i>Journal of applied sciences – SUT (JAS – SUT)</i> - <i>European Chronicle-</i> - <i>The Urban Book Series. Springer, 2021</i> - <i>The Urban Book Series. Springer, 2024</i> 2. Emri i bazës elektronike të revistave:	PO

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
	▪ Google Scholar ▪ IndexCopernicus International ▪ Academic Search Complete (EBSCO) 3. Titulli i punimit: 1) Kujtim Elezi, Nuran Saliu, Enis Jakupi. (2020). Bonta's interpretation of an architectural myth. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 6. No.11-12. 60-70. UDC: 2-264:72(497.7) 2) Nuran Saliu, Kujtim Elezi, Andrea Maliqari, Egzona Zendeli-Vejseli (2020). From Dimensional To Non-Dimensional Simple States: A Computational Design Method for Early Stages of Design. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 6. No.11-12. 71-84. UDC: 72.012:004.92-023 3) Fjolla Ibraimi, Nuran Saliu (2021). Understanding inclusive education and its impact on architecture. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 7. No.13-14. 34-45. UDC: 34.043.2:376-056.26/.36]:725.05(497.7) 4) Kujtim Elezi, Nuran Saliu (2021). Pristina and the Yale syndrome in architecture. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 7. No.13-14. 93-101. UDC: 72.036(497.115) 5) Kujtim Elezi, Nuran Saliu (2023). Housing quality in the city of berati: an analytical approach of typology and construction. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 9. No.17-18. 126-135. UDC: 711.4:728.1:94(496.5-51:560) 6) Nuran Saliu, Egzona Zendeli Vejseli, Kujtim Elezi, Andrea Maliqari. (2023). The interaction of simple states in complex architectural rectangular shapes. Journal of Applied Sciences-SUT. Vol 9. No.17-18. 159-170. UDC: 721.021.2:004.925 7) Nuran Saliu, Kujtim Elezi. (2025). Integration of artificial intelligence in floorplan layout planning: a systematic review of models, methods, and applications. European Chronicle, 10(1), 57–65. https://doi.org/10.59214/euch/1.2025.57 8) Nuran Saliu, Kujtim Elezi. (2025). The transformative integration of artificial intelligence in architectural practice: from generative design to sustainable building performance. European Chronicle, 10(1), 66–73. https://doi.org/10.59214/euch/1.2025.66 4. Data e publikimit : - Vol 6. No.11-12. 60-70 _ 2020 - Vol 6. No.11-12. 71-84 _ 2020 - Vol 7. No.13-14. 34-45 _ 2021 - Vol 7. No.13-14. 93-101 _ 2021 - Vol 9. No.17-18. 126-135 _ 2023 - Vol 9. No.17-18. 159-170 _ 2023 - Vol 10(1), 57-65 _ 2025 - Vol 10(1), 66-73 _ 2025	
3.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u	PO

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
